




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARI

Gramoz RUÇI



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHITETIT PËR VITIN 2020**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Autoritetit në përmbushje të misionit të tij për dhënie e informacionit për dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit, në mënyrë që të edukojë publikun e të mbështesë vlerat demokratike të drejtësisë, të vërtetën, pajtimin e përgjegjësinë për brezat e ardhshëm;

Duke konsideruar se veprimtaria e Autoritetit është udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, mbrojtjes së të dhënave personale, dhënies së informacionit publikut, institucioneve dhe medias në kohë dhe me cilësi;

Duke vlerësuar bashkëpunimin e Autoritetit me institucione të tjera vendase dhe institucione homologe ndërkombëtare për shkëmbimin e informacionit e të përvojës lidhur me objektin e punës së Autoritetit,

Shqyrtoi veprimtarinë e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish -Sigurimit të Shtetit për vitin 2020 dhe konstaton se:

- Ka përmbushur me sukses dhe brenda afateve të kërkuara procedurat për vlerësimin e cilësive etike morale dhe profesionale të kandidatëve për t'u zgjedhur në organet e reja të vetingut dhe në institucionet e tjera, të cilat kanë paraqitur kërkesa;

- Ka vijuar të hulumtojë në materiale arkivore duke prodhuar artikuj shkencorë, mediatikë, filma dhe dokumentarë specialë dhe ekskluzivë;

- Është angazhuar në bashkëpunimin me institucione partnere, organizata ose individë për të rritur ndërgjegjësimin për krimet e komunizmit dhe inkurajimin e dialogut me universitetet dhe akademikët;

- Ka vijuar rishikimin e urdhërave të brendshëm me qëllim garantimin e sigurisë për informacionin e klasifikuar që përpunohet dhe administrohet nga Autoriteti;

- Ka luajtur rol proaktiv duke mbështetur kërkimin shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit nëpërmjet garantimit të mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve dhe dorëzimin e dublikatave të dokumenteve.

Kuvendi rekomandon që Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2021 të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Të vijojë të bashkëpunojë dhe të bashkërendojë punën me institucionet qendrore dhe vendore në Republikën e Shqipërisë për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe për të mbrojtur dhe ruajtur në mënyrën më të përshtatshme vendet që janë aktualisht ose do të identifikohen si vendvarrime.
- Të marrë masa konkrete për përmirësimin dhe përshpejtimin e procesit të punës për trajtimin brenda afateve ligjore të kërkesave individuale, institucionale dhe studimore, si dhe kryerjen me cilësi të detyrave që i ngarkon ligji.
- Të ndërtojë një sistem të sigurt teknologjik të shërbimit të të dhënave sipas standardeve ndërkombëtare, që lehtëson kërkimin, gjurmimin dhe studimin e informacionit arkivor.
- Të intensifikojë përpjekjet për zgjidhjen e problematikës së krijuar për dorëzimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nga Arkivi i Sistemit të Ministrisë së Brendshme në respektim të zbatimit të marrëveshjes së përbashkët dhe të përfundojë procesi i marrjes në dorëzim i të gjitha dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nga institucionet arkivore në vend, në përmbushje të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit për vitin 2019.
- Të rishikojë faqen zyrtare *online* me qëllim që informacioni të jetë lehtësisht i aksesueshëm, i saktë dhe i plotë, për atë që e lejon ligji, në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale, interesit publik dhe sigurisë kombëtare.
- Të bëjë transparencën e vendimmarrjes në raportimin vjetor, ku të pasqyrohet mendimi kundër në rastet e vendimmarrjes jo unanime.
- Të përfshijë në raportimin vjetor të ardhurat nga shërbimet ndaj institucioneve dhe personave të tretë.
- Të intensifikojë marrëdhëniet me institucionet homologe të vendeve ish-komuniste si një mënyrë efektive për t'u njohur dhe përfituar nga përvoja e tyre në përmbushjen e misionit të Autoritetit.
- Të vazhdojë aktivitetet në kuadër të edukimit qytetar dhe kërkimit shkencor duke angazhuar grupet e interesit dhe përfshirë të rinjtë në aktivitetet për rishikimin e historisë dhe vënien në vend të dinjitetit njerëzor të personave që e vuajtën regjimin totalitar dhe të zhdukurve në komunizëm.

Miratuar në datën 3.6.2021